

43 ushtarë rezervistë të shërbimeve informative izraelite nuk kanë pranuar që të bëjnë spiunazh antipalestinez.

Rezervistët e njësisë së lartë të mbikëqyrjes elektronike të Izraelit kanë refuzuar që të përgjojnë palestinezët, të cilët jetojnë nën pushtimin izraelit, raporton Agjencia Anadolli (AA).

Në një letër drejtuar Kryeministrit Benjamin Netanjahu dhe shefave të shtabeve, 43 rezervistë të njësisë 8200 kanë deklaruar se nuk pranojnë të kryejnë çdo detyrë ushtarake, që do të forcojë pushtimin e Izraelit në territoret palestineze, njoftoi radioja izraelite.

Ata argumentuan se informatat e mbledhura nga njësia e tyre janë duke u përdorur për të ushtruar presionin ndaj civilëve palestinezë, për rekrutimin e tyre për të spiunuar për Izraelin.

Të themeluara në vitin 1952, njësiti 8200 janë detashmenti më i madh i ushtrisë izraelite, përgjegjëse për mbledhjen e informatave.

Ky veprim vjen dy javë pas ndërprerjes së ofensivës izraelite shtatëjavëshe në Rripin e Gazës, ku u vranë të paktën 2,156 palestinezë dhe u plagosën rreth 11,000 të tjerë, kryesisht civilë.

Të paktën 72 izraelitë u vranë gjithashtu në këtë ofensivë, prej të cilëve 67 ushtarë dhe pesë civilë, sipas shifrave të bëra publike nga Izraeli./trt/